

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Rama: Sistemi po lufton korrupsionin, unë dhe PS i dhamë drejtësisë pavarësinë - Euronews Albania
ADRESA	https://euronews.al/rama-sistemi-po-lufton-korrupsionin-une-dhe-ps-i-dhame-drejtesise-pa-varesine/
BURIMI	euronews.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	27 shtator 2026, 13:35:43 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	27 shtator 2026, 13:30:40 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	403d5e75377be1347e21ce14873f50a06bac0b54037a04d6be1b4fd9d98d4b07
TEKSTI	9ebc179cbe463c7a0c2a5bcf24d315a6ed9dce1ee0c9c36e551044790bad67ba
PAMJA	1da6045281c892c4589ca9e09c1d1b9db567ffdb4ce7cf9d062d06bb1315bb25

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	fca59c33ee911dc43aa20375c5302dd6bbc3156584536353c997680b4d4f8d4c
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	9def72ec67cc19e19d7afd89aaceb893ee05eec68643756bafa9738daebd45d
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/fca59c33ee911dc43aa20375c5302dd6bbc3156584536353c997680b4d4f8d4c>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.


Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

TREND

Edi Rama Donald Trump Shqipëri-Bjellorusi Policia Maliq

LAJMI I FUNDIT | POLITIKË

Rama: Sistemi po lufton korrupsionin, unë dhe PS i dhamë drejtësisë pavarësinë



27 Shtator 2026 | 15:30

Kryeministri Edi Rama deklaroi se reforma në drejtësi ka sjellë një sistem drejtësie që, sipas tij, po vepron i pavarur nga pushteti politik. Rama tha se reforma është meritë e tij dhe e PS-së, ndërsa e cilësoi një proces përmes të cilit pushteti politik dorëzoi "shpatën e drejtësisë" te një sistem gjyqësor i çliruar dhe i pavarësuar.

"Pavarësia e drejtësisë nuk ra nga qielli, nuk e solli as koha, as SHBA dhe as Europa. Ata ndihmuan, por pa ne do të kishin bërë një Noc Rrok. Nuk e solli pavarësinë e drejtësisë sorrat e korbat që bërtasin 'korrupsion' dhe shikojnë SPAK-un si armë kundër meje, që i kam mundur dhe i mund në çdo zgjedhje sa herë u bie mendja se më zunë ngushtë dhe më bënë gropën. Nuk është mundja e tyre ajo që më prish gjumin dhe as fryrja e pulëkakarisë së tyre. Kjo lidhet me çfarë po ndodh, me korrupsionin dhe drejtësinë. Nuk kthehet më koha kur pushteti politik dhe pandëshkueshmëria ishin e njëjta gjë. Ka ikur ajo kohë sepse unë dhe PS i hymë detit me këmbë dhe morëm përsipër reformën më të thellë dhe të dhimbshme, aktin e dorëzimit të shpatës së drejtësisë nga duart e pushtetit politik në duart e drejtësisë të çliruar dhe të pavarësuar. E bëra unë, jo se isha naiv, as se nuk e dija që do të kërkonte koka, por sepse ishte imja, jona barra e asaj sakrifice të madhe politike. Sot, për herë të parë në historinë e shtetit shqiptar, është vetë sistemi që po shfaq aftësi vetëpastrimi që s'i ka pasur kurrë. Kjo është arritje e madhe, autopsinë e së cilës nuk e negocioj me askënd", tha Rama.

Sipas Ramës, fakti që drejtësia prek ministra, drejtorë dhe kryetarë bashkish tregon se ajo vepron e pavarur nga pushteti politik.

"Në asnjë vend të mbytur me korrupsion nuk ka luftë frontale kundër korrupsionit. Në asnjë vend të mbytur prokuroria nuk heton vetë pushtetin, por i mbron ata. Në asnjë vend drejtësia nuk prek ministra, drejtorë, kryetarë bashkish, por vetëm rri dhe pret urdhrin e pushtetit për të goditur kundërshtarët. Vendin e mbytur në korrupsion e kemi jetuar të gjithë, ku kryetari i opozitës burgosej me urdhër nga lart, ku protestuesit vriteshin me plumba të paguar nga taksapaguesit, ku fletëthirret e prokurorisë për vrasjet shtetërore në mes të bulevardit bëheshin letra higjienike në zyrën e kryeministrit që denigronte prokuroren si lavire bulevardit, ku drejtori i taksave qëndronte në krye të detyrës nga arresti shtëpiak dhe 26 të pafajshëm të vrarë në shpërthimin e një projekti korruptiv të Ministrisë së Mbrojtjes u trajtuan si viktimë të fatkeqësisë natyrore. Ata 4 të vrarë në bulevard nuk kanë marrë drejtësi. Korrupsioni sot po përballet me një tjetër sistem, ku po zhvillohen organe që hetojnë në liri dhe pavarësi të plotë. Deri dje korrupsion ishte sistemi, sot sistemi po lufton korrupsionin, ky është ndryshimi epokal. Vetëpastrimi i sistemit është zhvillim i shumëpërdorur në organizimin e shtetit pas një agjie të natës sa historia e shtetit

LAJMI I FUNDIT

14:57 Rama: Askush s'më akuzon dot se kam vepruar kundër Shqipërisë, jam për të bërë histori, jo pasuri

14:48 Rama: Hetimi i Vlorë Hysenit i takon drejtësisë, mbrojtja e SHISH përgjegjësi e shtetit

14:43 "Kishte referenca të shkëlqyera nga partnerët", Rama: Vlorë Hyseni ka hyrë në një borxh të SHPËRNDAMADH moral me këtë vend
ARTIKULLIN

14:30 Rama mesazh nga Rinas: Masa ndaj kreut të SHISH ekstreme, u ekspozua një institucion i rëndësishëm së veçantë

14:18 Shkodër, zjarr në çatinë e një hoteli në qendër të qytetit, ndërhyjnë zjarrfikëset

14:11 Pritet mesazhi i Ramës, Berisha mbërrin në Rinas, do udhëtojë drejt Strasburgut

TESTIM

shqiptar. Pas një agonie të gjatë sa historia e shtetit shqiptar, organizmi i shtetit po fiton imunitet nga sëmundjet e vjetra dhe, kur kjo fazë e zhurmshme, e pistë dhe e dhimbshme të ketë kaluar, kur emrat, sekretet, jargët, shkrofëtimat dhe piskamat e tezgave mediatike të jenë fashitur, kur tymi i pasqyrave dixhitale të jetë shpërndarë dhe pluhurat e kantierit të Reformës në Drejtësi të jenë tretur, atëherë të gjithë do ta shohin se këto zhvillime janë pjesë jetike e ndryshimit rrënjësor pa kthim ku po ecën sot Shqipëria. Sot unë jam kthyer në Shqipëri, por Shqipëria nuk kthehet pas. Askush dhe asgjë nuk do ta ndalë, nuk do të na ndalë, nuk do të më ndalin”, tha Rama.

Shiko në:

LAJME TË SUGJERUARA

LAJMI I FUNDIT | SPORT

Shqipëria e nis me fitore Ligën e Kombeve, mposht 2-0 Bjellorusinë

Kombëtarja e Shqipërisë e ka nisur me fitore aventurën e re në Ligën e Kombeve. Kuqezinjtë triumfuan 2-0 ndaj Bjellorusisë të shtunën mbrëma në stadiumin...

07:00 | 27/09/2026

LAJMI I FUNDIT | POLITIKË | VENDI

Debate për Vlora Hysenin, Zhupa: Po digjen themelet e shtetit, Malaj: Përgjegjësia është individuale

Për të dytën ditë radhazi, komisionet parlamentare janë përfshirë nga debatet pas vendosjes së masës së sigurisë ndaj ish-drejtoreshës së SHISH, Vlora Hyseni. Këtë të...

13:33 | 25/09/2026

LAJMI I FUNDIT | POLITIKË | VENDI

Mbledhja e Këshillit të Sigurimit, reagon Bardhi: Shqiptarët nuk kanë nevojë për spektakël institucional

Pas vendimit të Presidentit Bajram Begaj për të mbledhur Këshillin e Sigurimit Kombëtar, pas masës së arrestit ndaj ish-drejtuësës së SHISH, Vlora Hyseni, ka reaguar...

13:14 | 25/09/2026

TEMA	SHËRBIME	KOMPANIA
Vendi	Live	Rreth Euronews
Rajoni	Lajmi fundit	Kushtet e përdorimit
Bota	Na ndiqni	Politika e cookie
Video	Euronews Radio	Kontaktoni
	Për persona me aftësi të kufizuara	Punësimi

Follow Euronews on all platforms: